

KOMENTET SHITES TË KEK-UT NDAJ RAPORTIT KONSULTDHE RREGULLIMEVE TË PROPOZUARA TË ZRRE-SË PËR TË HYRAT E LEJUARA

KEK-u me respekt i dorëzon këto komente dhe shpjegime shtesë lidhur me propozimet e rregulluara nga ZRrE-ja për të Hyrat e Lejuara të dorëzuara nga KEK-u.

Zhvlerësimi i CAPEX-it dhe Rregullimi i Kthimit

KEK-u nuk pajtohet me zvogëlimin prej € 7.9 milion nga ZRrE-ja për zhvlerësimin e CAPE-it dhe kthimin. Ky zvogëlim do të rezultojë që KEK-u të mos i ketë të hyrat për vitin 2009 për të financuar pajisjet e reja të nevojshme. Sikur KEK-u vërtet t'i kishte inkasuar fondet nga konsumatorët në vitin 2008, dhe ta kishte tejkualuar shumën e të hyrave të lejuara, atëherë ZRrE-ja to të mund të justifikojë për atë që KEK-u t'ia kthej konsumatorëve shumën e tejkualuar. Megjithatë, KEK-u nuk i ka inkasuar të Hyrat e Lejuara nga ZRrE-ja në vitin 2008, në fakt ka qen larg më pak sesa ajo shumë. Kështu që KEK-u nuk i ka tejkualuar të hyrat në shumën që ZRrE-ja ka propozuar të rregullohet, kështu që rregullimi i propozuar për kthimin nuk është i justifikuar.

Pajisjet e Mihjes dhe Zhvlerësimi

KEK-u nuk pajtohet me propozimin e ZRrE-së që jetëgjatësia e amortizimit për pajisjet e mihjes të jetë 35 vite. Jeta adekuate e mbetur sipas të cilës duhet të bëhet zhvlerësimi i shpenzimeve kapitale për pajisjet e mihjes është 15 vite. Kjo bazohet në dy faktorë domethënës.

1. Shpenzimet kapitale që janë bërë në mihje kanë për qëllim kryesorë të ja "Zgjasin Jetën" pajisjeve. Shumica prej pajisjeve ekzistuese janë blerë para 20 deri 30 vite më parë dhe shpenzimet që janë bërë tani pritet që të zgjasin jetën e tyre edhe për 15 vite.
2. Shpenzimet Kapitale të Mihjes janë duke u financuar nga një hua që i është dhënë KEK-ut nga Qeveria e Kosovës, me një afat kthimi në 15 vitet e ardhshme. Mbulimi i kostos së pajisjeve në formën amortizimit dhe kthimit në investim në periudhën e 15 viteve të ardhshme është kritike për të përmbushur nevojat KEK-ut për shërbimin e borxhit (pagimi borxhit dhe kamatës) ndaj Qeverisë. Është e rëndësishme të vërehet se KEK-u nuk ka qasje në tregjet kapitale, kështu që, duhet ta mbështes mbulimin e kostove kapitale përmes tarifave.

Shërbimet e Korporatës

Shërbimet Mbështetëse të Korporatës (AQ) po vazhdojnë përpjekjet e tyre për të rritur efikasitetin, të përmirësojnë shërbimin e KEK-ut ndaj konsumatorëve dhe të vazhdojnë t'i zvogëlojnë humbjet komerciale. Megjithatë, që këto përpjekje të zbatohen kërkohet një rritje në buxhetin e vitit 2009, siç reflektohet në Aplikimin Tariforë të KEK-ut. Artikuj kryesor të buxheti janë përshkruar këtu:

Auditimi i Brendshëm, Anti Korrupsioni, dhe Zyra për Mbrojtjen e Të Hyrave:

KEK-u është duke e forcuar Njësinë e vetë të Auditimit të Brendshëm për të përmirësuar kontrollet e brendshme në të gjitha veprimtarit e tij. Njësia e Anti Korrupsionit është e

përqendruar në veçanti në zbulimin dhe parandalimin e mashtrimit dhe vjedhjeve nga ana e punëtorëve të KEK-ut. KEK-u poashtu po ndërton një Departament për Mbrojtjen e Të Hyrave me fokusim në zvogëlimin e humbjeve komerciale. Kjo kërkon shtimin e një personeli të shkathët prej 54 persona. Kostot operative në vitin 2009 për këtë njësi pritet të jenë 550,000 Euro.

Teknologjia Informatike:

Kërkohet personel i ri me aftësi të avancuara në Administrimin e Bazës së të Dhënave, Menaxhimin të Rrjetit, Komunikimit, dhe Zhvillimin e Programeve Aplikative. Numri i personave shtesë që hynë në buxhetin e këtij departamenti është 3.

Kostot operative për Departamentin TI-së janë me buxhet më të lartë në vitin 2009 për shkak të kësaj që vijon:

- OPEX-i shtesë lidhur me pjesëmarrjen e KEK-ut në projektin CLRP të Bankës Botërore -€650,000
- Kostot shtesë të TI-së lidhur me; a) krijimin e një qendre të re të të dhënave në ndërtesën e Elektro-Kosovës dhe lëvizjen e Serverit, rrjetit, dhe pajisjeve të komunikimit të TI-së nga Toskana në Elektro-Kosovë - €365,000; b) ofrimi i mundësive shtesë të komunikimit për të gjitha zyrat e konsumatorëve me një linjë të dytë të komunikimit ashtu që zyrat të mund t'i procedojnë pagesat në rast të ndonjë ndërprerje të linjës kryesore - €132,000;
- Ripërtëria e licencave të softuerit dhe pagesat prej €247,000
- Auditimi dhe konsultimi lidhur me regjistrimin e një kompanie të re të Rrjetit dhe Furnizimit - €150,000;
- Mirëmbajtja shtesë në ndërtesën e Elektro-Kosovës lidhur me lëvizjen e AQ-së së KEK-ut nga Toskana dhe modifikimin e hapësirës së zyrave për të akomoduar për DISCO-në e re të regjistruar. €218,000.

Marrëdhëniet me Publikun:

Është e natyrshme që KEK-u duhet patjetër të bëhet më efektiv në menaxhimin e marrëdhënieve të tij me publikun dhe shtypin. Privatizimi i afërt shton edhe më shumë komplikime në këtë detyrë. Numri i personelit me buxhet është paraparë të rritet për 3 veta dhe kërkohen të shtohen shpenzime operative për €150,000.